



A ia vlen të merret BCG-ja në moshë të rritur ose për udhëtim?

Studimet sugjerojnë se BCG-ja ka një ndikim të vogël te personat mbi 35 vjeç. Vetëm të rriturit nën 35 vjeç të cilët punojnë në profesione me rrezik të veçantë, si p.sh. ata që punojnë në shëndetësi, me të moshuarit, në strehimet për të pastrehët dhe refugjatët, stafi laboratorik, stafi i burgut dhe stafi veterinar mund të rekomandohen për të marrë BCG-në. Fëmijët nën 16 vjeç të cilët nuk e kanë marrë BCG-në dhe do të vizitojnë/do të rrinë për më shumë se tre muaj në një vend me një shkallë të lartë të tuberkulozit, këshillohen të bëjnë një test lëkure për të parë nëse nevojitet BCG-ja. Zakonisht, BCG-ja për udhëtime dhe testimi për të do të duhet të kryhet në mënyrë private.

A mund ta marrë kushdo tuberkulozin?

Cilido mund të infektohet me tuberkuloz (lista e ish-pacientëve përfshin një ministër të kabinetit të MB-së, disa këngëtarë me famë botërore dhe një kryepeshkop!) por ai ka më shumë gjasa të infektojë personat me kushte të varfra jetese dhe me dieta të varfra (si p.sh. të pastrehët ose personat që jetojnë në vendet në zhvillim) dhe ata me sëmundje të tjera - veçanërisht me HIV.

Kujt t'i drejtohem nëse jam i shqetësuar rreth tuberkulozit?

Nëse jeni të shqetësuar se ju ose dikush që njihni mund të ketë disa nga simptomat e tuberkulozit, ju duhet të flisni me doktorin tuaj rreth kësaj.

A mund të shfaqet përsëri tuberkulozi?

Përgjigjja e thjeshtë është po-kjo është e mundur, pra nëse keni ndonjë dyshim, ju lutemi këshillohuni me mjekun tuaj.

Sa i zakonshëm është tuberkulozi?

Tuberkulozi është shumë i zakonshëm në vendet ku njerëzve ose nuk u jepet mundësia e trajtimit efikas, ose nuk mund ta përballojnë atë financiarisht. Gjithashtu, turpi që e rrethon këtë sëmundje mund t'i pengojë njerëzit që të

kërkojnë mjekim. Kjo është arsyeja pse tuberkulozi vret rreth 2 milion njerëz çdo vit - megjithëse mund të kurohet.

Në MB ka një rritje të përgjithshme prej 20% në dekadën e fundit me një rritje prej 50% në Londër. Shifrat ende vazhdojnë të rriten.

A mund të kontaktoj me pacientë/grupe të tjerë për mbështetje?

Nëse dëshironi të flisni me pacientë të tjerë, ju lutemi kontaktoni **TB Alert**. Të dhënat e kontaktit mund të gjenden në pjesën e pasme të kësaj broshure.

A mund të bëj diçka për të ndihmuar?

Ju mund të bëheni një mik i **TB Alert**, bamirësisë që synon të promovojë ndërgjegjësimin për tuberkulozin dhe të financojë projekte në MB dhe në vendet në zhvillim.

Pse na duhet ndihma dhe mbështetja juaj

TB Alert punon me profesionistë mjekësorë, me qeverinë, me organizata të tjera jo-qeveritare dhe me publikun për të rritur ndërgjegjësimin rreth tuberkulozit në MB. **TB Alert** kryen gjithashtu fushata për t'i dhënë një përparësi më të madhe tuberkulozit, në mënyrë që më shumë njerëz në mbarë botën të mund ta përdorin kurën që meritojnë.

TB Alert mbështet projektet në vendet në zhvillim, në mënyrë që TË GJITHË pacientët të marrin trajtimin e duhur.

TB Alert është e vetmja lëvizje bamirësie, specialiste për tuberkulozin që funksionon në MB dhe në mbarë botën për të luftuar tuberkulozin.

Ju mund të ndihmoni!

Mbroni familjen dhe miqtë nga TB - merrni të gjitha ilaçet e TB-së



TB Alert,
Community Base,
113 Queens Road,
Brighton BN1 3XG
Tel: 01273 234030

Për informacione të mëtejshme ose për kopje të kësaj broshure, ju lutemi kontaktoni 01273 234 770 (vetëm në orarin zyrtar).

Për të bërë një donacion ose për të dalë vullnetar për të ndihmuar **TB Alert**, ju lutemi kontaktoni 01273 234 784 (vetëm në orarin zyrtar).

Ose vizitoni faqen tonë të internetit në www.tbalert.org

TB Alert është një vepër unike bamirësie, që rrit ndërgjegjshmërinë në MB për tuberkulozin dhe që po mbështet punën e NHS-së, duke ofruar informacione për pacientët. Ne mbështesim projektet në vendet që janë në zhvillim duke siguruar që të gjithë pacientët të marrin trajtimin e duhur. Me mbështetjen tuaj, ne mund të arrijmë një ndikim shumë të madh pozitiv, në mbarë botën për tuberkulozin dhe të shpëtojmë më shumë jetë.

President nderi: Sir John Crofton MA MD FRCP (Ed and Lon)
Patron: Kryepeshkopi Desmond Tutu
Kryetar: Z. Paul Sommerfeld
Sekretar: Prof. Peter Davies

Informacioni i dhënë në këtë broshurë rreth diagnozës dhe trajtimit të tuberkulozit ka i synim të japë informacion të përgjithshëm rreth subjektit. Ai nuk mendohet të zëvendësojë njohuritë, ekspertizën, aftësitë dhe gjykimin e mjekëve, farmacistëve dhe/ose profesionistëve të tjerë të shëndetësisë në kujdesin ndaj pacientit. Asnjë nga informacionet që përmban kjo broshurë nuk mendohet të përdoret për të marrë vendime për diagnozën ose trajtimin. Pyetjet dhe shqetësimet lidhur me diagnozën dhe trajtimin duhet t'i drejtohen një mjeku profesionist të kujdesit shëndetësor.

Një kompani jo fitimprurëse Regjistruar në Angli Nr. 3605528 Nr. i regjistrimit të Bamirësisë 1071886 dizajni: woksong, london 020 8552 8300



TUBERKULOZI Pyetjet tuaja gjejnë përgjigje

e e madhe
gjatë natës
temperaturë
e pashpjegueshme në
Djersitje e madhe gjatë natës Me ose pa kollë
Temperaturë!! Temperaturë!! Temperaturë!!
Djersitje e madhe gjatë natës Me ose pa kollë
Letargji!! Temperaturë!! Letargji!! Letargji!! Temperaturë!! Letargji!!
Me ose pa kollë Gjëndra të ënjtura
Temperaturë!! Temperaturë!! Temperaturë!! Djersitje e madhe gjatë natës
Gjëndra të ënjtura Gjëndra të ënjtura
Temperaturë!! Humbje e pashpjegueshme në moshë
Temperaturë!! Djersitje e madhe gjatë natës
Djersitje e madhe gjatë natës Me ose pa kollë



Çfarë është tuberkulozi?

Tuberkulozi (TB) është një infeksion bakterial që haset në mushkëri por që mund të ndikojë çdo pjesë të trupit. Tuberkulozi është gati gjithmonë i mjekueshëm nëpërmjet një cikli mjekimi që zgjat zakonisht 6 muaj. Vetëm tuberkulozi i mushkërive ose i fytit mund të jetë infektues dhe pjesa më e madhe e njerëzve nuk do të jenë infektues brenda dy javëve nga marrja e ilaçeve të duhura.

Si merret tuberkulozi?

Kur një person i infektuar me tuberkuloz të mushkërive kollitet, mikrobet mund të futen në ajër në formën e piklave dhe njerëzit e tjerë mund t'i marrin ato nëpërmjet frymëmarrjes. Personat që kanë më shumë gjasa që të infektohen me tuberkuloz, janë ata të cilët kanë kaluar një kohë të gjatë pranë personave me tuberkuloz (zakonisht partnerët dhe njerëzit e tjerë brenda një shtëpie, ose shumë rrallë kolegët e afërt të punës). Ka shumë pak mundësi që dikush të mund të infektohet me tuberkuloz në vende të tilla si p.sh. në autobus ose në një tren, meqenëse kontakti për disa orë me dikë që është i infektuar është zakonisht i domosdoshëm për të qenë i rrezikuar nga infektimi. Tuberkulozi nuk përhapet nëpërmjet pështymës ose shkëmbimit të objekteve.

Si mund të më prekë mua tuberkulozi?

Pacientët me tuberkuloz mund të kenë disa simptoma si më poshtë:

- Kollë që zgjat më shumë se tre javë nuk reagon ndaj barnave normale dhe përkeqësohet
- Ethe (temperaturë të lartë)
- Djersitje aq e madhe gjatë natës saqë duhet të ndërroni çarçafët
- Humbje e peshës pa asnjë arsye

- Lodhje (mungesë energjie ose lodhje e tepërt)
- Gjëndra të ënjtura
- Humbje oreksi
- Kollë me gjak (kjo ndodh shumë rrallë por kërkon këshillim të menjëhershëm mjekësor)

Tuberkulozi në pjesë të tjera të trupit mund të shkaktojë dhimbje dhe ënjtje. Te fëmijët dhe rrallë te të rriturit, tuberkulozi mund të shkaktojë meningjit.

Të gjitha këto simptoma mund të jenë shenja të problemeve të tjera, por nëse ju keni tre ose më shumë nga ato dhe jeni të shqetësuar, ju duhet të flisni me një doktor ose me një infermiere në ambulancën ose në klinikën tuaj lokale.

Si diagnostikohet tuberkulozi?

Juve do t'ju kërkohet të jepni një mostër të këlbazës në të cilën bakteret që e shkaktojnë tuberkulozin, nëse janë të pranishme, mund të shihen me mikroskop ose të rriten në një mjedis kulture në laborator. Në disa rrethana, juve mund t'ju ofrohet një test lëkure, një test gjaku ose një test me rreze x për krahërorin.

A duhet të shtrohem në spital nëse kam tuberkuloz?

Jo, megjithatë ju mund të shtroheni për një kohë të shkurtër për të konfirmuar diagnozën.

Cili është trajtimi për tuberkulozin?

Doktori ose infermierja juaj e TB-së do t'ju japin katër ilaçe të ndryshme për dy muaj. Ato janë:

- Rifampicin
 - Isoniazid
 - Pyrazinamide
 - Ethambutol
- (Isoniazid-i, Rifampicin-a dhe Pyrazinamide mund të kombinohen si Rifater).

Pas 2 muajsh ose nëse bakteret të jenë testuar kundër ilaçeve që po ju jepen, trajtimi mund të reduktohet në dy ilaçe, ISONIAZID dhe RIFAMPICIN (mund të kombinohen si Rifinah).

A mund të shkaktojnë efekte anësore këto tableta?

Rifampicin-a do bëjë që urina dhe sekrecionet e tjera të trupit, si p.sh. lotët, të marrin një ngjyrë të kuqe në portokalli.

Ajo bashkëvepron gjithashtu me ilaçe të tjera, në veçanti ajo redukton efikasitetin e kontrceptivëve hormonalë (oralë, të futur ose të tjerë). Prandaj, është e rëndësishme ta paralajmëroni doktorin tuaj kur ju jep ilaçe të tjera se po i nënshtroheni trajtimit të tuberkulozit.



Tabletat mund të shkaktojnë rrallë disa simptoma si më poshtë:

- Acarim të lëkurës
- Të përzier
- Pickime dhe shpime
- Verdhëz (zverdhje të lëkurës ose syve). Nëse ju e vëreni këtë, ndërpriteni të gjitha ilaçet e tuberkulozit dhe kërkonin menjëherë kujdes mjekësor.

Nëse këto shkaktohen, kontaktoni një infermiere ose një doktor tuberkulozi.

Çfarë do bëhet me personat që kam pasur kontakt të afërt?

Juve do t'ju kërkohet nga infermierja specialiste e tuberkulozit që të bëni një listë me personat me të cilët kaloni pjesën më të madhe të kohës. Atyre do u kërkohet që të shkojnë për ekzaminim në klinikën e sëmundjeve të krahërorit. Kjo mund të përfshijë një test gjaku ose një test lëkure, dhe/ose rreze x për krahërorin.

A mund të parandalohet tuberkulozi?

Ekziston një vaksinë që njihet si BCG. Ndonëse nuk funksionon për të gjitha rastet, ajo është më efikase te fëmijët e vegjël kundër formave më të rënda të tuberkulozit, si p.sh. meningjiti nga tuberkulozi. BCG-ja është vakcina më e përdorur në planet por megjithatë, 9 milionë njerëz (pjesa më e madhe e të cilëve e kanë marrë më parë BCG-në) çdo vit ende sëmuren nga tuberkulozi. Vaksina të reja janë në zhvillim e sipër. Në MB, BCG-ja tani ofrohet te foshnjat që rrezikohen shumë nga infektimi me tuberkuloz dhe te disa të rritur në situata të një rreziku të veçantë. Për informacione më të hollësishme, telefononi në 0845 456 0995 për broshurën tonë të BCG-së.

Do të doja të isha një mik i TB Alert nëmënyrën (mënyrat) e mëposhtme

(Ju lutemi shënoni me ☒ kutinë e duhur më poshtë)

A. Duke bërë një donacion

☐ Çek i mbyllur për GBP
(I pagueshëm për TB Alert)

☐ Ju lutem, trajtojeni këtë dhe donacionet e ardhshme si donacione Ndihme Dhuratë. Unë jam një taksapagues i MB-së.*

Data:

*nëse e shënoni këtë kuti, TB Alert mund të pretendojë 28,2 pens nga Të Ardhurat e Brendshme për çdo paund të dhuruar, dhe nëse jeni një tatimpagues i madh, ju mund ta merrni përsëri vetë diferencën mes tatimit të ulët dhe të lartë. Ju lutemi, na njoftoni nëse nuk paguani më taksa për të ardhurat nga paga ose taksën e fitimeve kapitale, të barabartë me kategorinë bazë të taksës së të ardhurave.

- ☐ Dua të filloj një donacion të zakonshëm – ju lutem, më dërgoni një formular të rregullave në zbatim
- ☐ Planifikoj të lë para për **TB Alert** në testamentin tim.

B. Duke u bërë një vullnetar

Jam veçanërisht i interesuar të përfshihem në:

- ☐ Avokaturë dhe në punët e shtypit/medias
- ☐ Ngritjen e fondeve në zonën time
- ☐ Evenimente sfiduese ose sportive
- ☐ Intervistimin nga media (vetëm për pacientët/ish-pacientët)
- ☐ Ndihmë në detyrat administrative

Ju lutemi, shkruani me GERMA TË MËDHA

Data:ulli Z/znj/znsh ose tjetër:
(Ju lutemi, rrethoni të duhurën)

Mbiemri:

Emri(emrat):

Adresa:

.....

..... Kodi postar:

Telefoni:

Faksi:

E-maili:

☐ **TB Alert** do t'i mbajë të dhënat tuaja në bazën tonë të të dhënave dhe do t'ju dërgojë përditësime rreth punës sonë. Ne nuk do t'ju dërgojmë shumë letra! Nëse preferoni të mos merrni letra nga ne, ju lutemi vini shenjë këtu.

☐ Ju lutemi, klikoni këtu nëse nuk dëshironi që **TB Alert** t'japë emrin tuaj organizatave të tjera të ngjashme